



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të Rregullores nr. 01/2017, neni 31 paragrafi 2, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe vendimit nr. 01-141-2023, i datës 08.02.2023, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shpall:

## K O N K U R S

### **1. KQZ-16/2023 Zyrtar i Lartë për Financa (Zotues)**

<b>Grada/Koeficienti:</b>	Niveli Profesional – G 7/ K-12.8
<b>Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë:</b>	Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Pa afat
<b>Vendi:</b>	Prishtinë

### **Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:**

1. Siguron dhe mban evidencën e zotimeve sipas planit buxhetor;
2. Përgatitë dhe kompletton lëndët për pagesë me dokumentacionet valide përcjellëse dhe të nënshkruara nga zyrtarët përkatës ;
3. Është përgjegjës për regjistrimin e zotimit në SIMFK;
4. Në bashkëpunim me Menaxherin e Personelit bën llogaritjen e pagave dhe kompensimeve në përputhje me buxhetin,
5. Përgatit raportin mujor, tremujor dhe vjetor në lidhje me mjetet e zotuar dhe të realizuara,
6. Pranon faturat dhe verifikon nëse janë paguar dhe i proceson për pagesë,
7. Kryen dhe detyra tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi.

### **Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:**

1. Diplomë Universitare në Ekonomi, Financa dhe të ngjashme;
2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale,
3. Integritet të lartë personal dhe profesional;
4. Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
5. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
6. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare e dëshirueshme;
7. Njohje e gjuhës angleze me gojë dhe me shkrim e dëshirueshme;
8. Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

*Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 21, kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës,, Rruga “Migjeni” 10000 Prishtinë, përmes postës elektronike në adresën: [zyra.personeli@kqz-ks.org](mailto:zyra.personeli@kqz-ks.org) dhe me anë të shërbimit postar.*

*Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KQZ-së, në linkun: [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org). Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.*

*Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi: **kualifikimin, përvojën e punës dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni, certifikatën që nuk jeni nën hetime, si dhe dy formularët e fundit të vlerësimit nga institucioni ku keni punuar.***

*Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Konkursi është i hapur prej datës: **24.02.2023 deri me datë: 13.03.2023** në ora 16:00.*

*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.*